

RAPORT I NDIKIMIT TE MJEDISIT

***“NDËRTIM KUZ LAGJA “KORRIKU”, FSHATI MAZHE E MADHE,
NJ.A.BUBQ, KRUJË”.***

DREJTUSI I FIRMËS “ERALD-G”SH.P.K

Inxh.Gëzim Islami

TIRANE 2023

PËRMBAJTJA

1	Hyrje	4
1.1	Kuadri institucional dhe ligjor ne lidhje me vlerësimet e ndikimit në mjedis	5
1.1.	Kuadri Kombëtar Ligjor dhe Administrativ	6
2	Aspekte teknike të projektit.....	6
2.1	Gjendja ekzistuese.....	7
2.2	Përshkrimi i projektit të propozuar.....	7
3	Ambjenti ekzistues	8

3.1	Arkeologjia dhe trashëgimia kulturore.....	8
3.2	Terreni dhe vendet me pamje te veçantë	9
3.3	Klima.....	9
3.4	Gjeologjia dhe dherat	12
3.5	Hidrologjia, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	13
3.6	Habitati dhe biodiversiteti	13
3.7	Cilësia e ajrit.....	13
3.8	Zhurma	14
3.9	Komuniteti lokal dhe aspektet social – ekonomike.....	14
4	Impaktet e rëndësishme mjedisore	15
4.1	Arkeologjia dhe trashëgimia kulturore.....	15
4.2	Terreni dhe vendet me pamje të veçantë	16
4.3	Klima.....	16
4.4	Gjeologjia dhe dherat	16
4.5	Hidrologjia, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	16
4.6	Habitati dhe biodiversiteti	17
4.7	Cilësia e ajrit.....	17
4.8	Zhurmat	18
4.9	Komuniteti lokal dhe aspektet social – ekonomike.....	18
5	Masat e propozuara lehtësuese	19
5.2	Masat e veçanta	20
5.2.1	Arkeologjia dhe Trashëgimia Kulturore.....	21
5.2.2	Terreni dhe vendet me pamje të veçantë	22
5.2.3	Gjeologjia dhe Dherat	22
5.2.4	Hidrologjia, Ujërat Sipërfaqësore dhe Nëntokësore.....	23

5.2.5	Habitati dhe Biodiversiteti.....	23
5.2.6	Cilësia e Ajrit.....	24
6	Monitorimi i mjedisit	24
7	Aneke.....	25

1. HYRJE

Projektet e ndërtimit të rrugëve e kanalizimeve, rikonstruksionit dhe ndërtimit të linjave kuz rezultojnë në krijimin e kushteve lehtësuese për një rajon të dhënë që ka paraqitur vështirësi dhe levizje të kufizuara të mjeteve dhe mallrave. Ato së paku përmirësojnë cilësinë e lëvizjes në rrugët egzistuese. Në një situatë të tillë sidoqë të kryhet ndërtimi ato do të kenë efekte ndikuese në gjendjen natyrore të rajonit. Kjo lidhet si me ndikimet e ndërtimit ashtu edhe me ato të karakterit operativ për shkak të trafikut. Duke vijuar me tej, ndërtimi dhe shfrytëzimi do të ketë ndikime direkte ose indirekte në aspektet social – kulturore dhe social – ekonomike të “status quo-s”.

Natyra e pyetjeve të shumta dhe të ndryshme që lindin në këtë rast kërkojnë marrjen e tyre në konsideratë gjatë aktiviteteve të ndërtimit dhe të shfrytëzimit. Ajo që kërkohet në këtë rast është trajtimi në mënyrë individuale të segmenteve rrugore dhe ndërhyrjeve.

Objekti i kësaj hyrje – përmbledhje për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të objektit “Ndërtim KUZ Lagja “Korriku”, fshati Mazhe e Madhe, Njësia Administrative Bubq, Krujë”, të minimizojë streset në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit, si dhe

- të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është që të përbëjë një mjet nëpërmjet të cilit të bëhet e mundur që projekti i rrugës dhe infrastruktura të implementuara në kuadrin e Projektit të Integruar të

Qeverise Shqiptare të jenë në përputhje me legjislacionin ekzistues, aktet nënligjore dhe zakonet në Shqipëri, si dhe me Politikën Operative të Bashkisë Krujë mbi Vlerësimin Mjedisor. Zhvendosjen e Detyruar dhe Trashëgiminë Kulturore, si dhe të mos kenë efekte të zgjatura negative mbi popullsinë e vendit, mjedisin natyror apo objektet me vlera të veçanta kulturore.

Në këtë kuadër do të realizohet projekti i rrugës “Ndërtim KUZ Lagja “Korriku”, fshati Mazhe e Madhe, Njësia Administrative Bubq, Krujë”.

Përgatitja e këtij Raporti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është bërë duke u bazuar në Termat e Referencës të Projektit si dhe duke marrë në konsideratë dhe Kuadrin e Masave për Mbrojtjen Mjedisore dhe Sociale për Njësine Bubq. Konsulenti e ka përshtatur Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e mjedisit si dhe ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Dokumenti mundëson një përmbledhje të përgjithshme të të dhënave në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Planin e Menaxhimit Ambiental (PMA), duke përfshirë kuadrin ligjor dhe politik si dhe standardet ambientale të aplikueshme, informacionin kryesor ambiental, impaktet potenciale të kthyeshme për ambientet fizike, ekologjike dhe social – ekonomike në zonën e Projektit, masat lehtësuese, programet e konsultimit publik etj.

1.1. Legjislacioni në lidhje me vlerësimin e impakteve në mjedis

Në kushtetutën e Republikës së Shqipërisë kërkohej: “...mirembajtje e një ambjenti tepër të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm”. Kjo, por edhe opinioni i tërë shoqërisë i shprehur nepermejt ligjeve të tjera, detyron marrjen e masave imediate për rehabilitimin e mjedisit të degraduar gjatë “epokës së industrializimit socialist” dhe ruajtjen e tij nga aktivitetet e sotme prodhuese/ndertuese që gjithashtu shkaktojnë dëmtime të mjedisit. Legjislacioni në lidhje me ruajtjen e mjedisit është në përputhje me normativat europiane të mbrojtjes së tij ndonëse cilësia mjedisore është ende në parametra mjaft të ulët. Ligji i parë për mbrojtjen mjedisore daton në vitin 1993 dhe shprehet se : “të gjitha veprimtaritë e personave fizike dhe ligjore, vendas apo të huaja, që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të jenë tema të vlerësimeve mjedisore”. Me tej, Ligji Nr. 8934, mbi mbrojtjen mjedisore përcakton se : “mbrojtja mjedisore është detyrim i” të gjithë shtetasve dhe individëve me veprimtari në Shqipëri”

Ne lidhje me vleresimin e ndikimit ne mjedis – VNM eshte aprovuar dhe funksionon Ligji Nr. 8990, date 03.01.2003 “mbi impaktet mjedisore” i cili percakton te gjitha procedurat per pergatitjen dhe paraqitjen per miratim te VNM ne Republiken e Shqiperise.

Ligji Nr.8990 ka per qellim per te siguruar mundesimin e :

a) Nje vleresimi te pergjithshem me nderthurje te impakteve ambjentale te projekteve apo veprimtarive qe do te realizohen me qellim qe te parandalojne dhe te menjanojne efektet negative ne mjedis ne kohen e duhur.

b) Nje pjese te procesit te vleresimit administrues me pjesemarrjen e institucioneve lokale dhe qendrore, institucioneve publike dhe organizatave jo fitim prurese per ambjentin, promovuesit te projektit, specialisteve te ambjentit dhe personave juridike te specializuar ne ceshtjet ambjentale.

Per kete projekt, neni 26 i ligjit nr. 8990 kerkon pjesemarrje publike ne procesin e Vleresimit te Impaktit Ambjental ne linje me kerkesat e legjislacionit te ri ambjental dhe direktivave perkatese te BE.

Rregulloret me te rendesishme dhe ligjet e aplikuar per VNM-n jane si me poshte:

— Ligji nr. 8934 “Per mbrojtjen e mjedisit”;

— Ligji Nr. 8990 “Per Studimet e Vleresimeve Mjedisore”;

— Laë Nr. 8093 “Per burimet e ujrave” nga viti 1996 e permiresuar nga Ligjet Nr. 8375, 8605, 8736;

— Ligji Nr. 8897 “Per mbrojtjen e ndotjes se ajrit”;

— Ligji Nr. 8561 “Per rivendosjen dhe shfrytezimin e perkohshem te prones per interes publik”;

— Ligji Nr.7623 “Per pyjet dhe mbrojtjen e tyre” nga viti 1992 e ndryshuar nga nenet 63 dhe 64 nga

- Ligji Nr. 7839 “Per shfrytezimin e pyjeve”; dhe

— Ligji Nr. 7866 “Per Referendumin” qe perfshin ceshtjet e vecanta mjedisore

2-ASPEKTE TEKNIKE TE PROJEKTIT

Projekti konsiston ne realizimin e objektit “Ndërtim KUZ Lagja “Korriku”, fshati Mazhe e Madhe, Njësia Administrative Bubq, Krujë” me nje infrastrukture bashkekohore. Pergatitjen e skemes finale per punimet e listuara ne fletet e dhena per zonen si linjat e kub, rrjetin rrugor ashtu sic kerkohet ne detyren e projektimit, perfundimi i llogaritjeve të shtresave rrugore, pergatitja e profilave terthore pergatitja e profilave gjatesore e detajeve. Vizatimet duhet te jene te qarta dhe koncize dhe te prezantohen ne nje menyre te tille qe te mund te kuptohen dhe interpretohen lehtesisht nga kontraktori.

2.1 Gjendja ekzistuese

Kanalizimet e ujërave të zeza të Lagjes Karriku nuk eshte në gjendje te mirë pasi janë me gropa septik edhe për shkakun e mungesës së investimeve në to. Tombinot e kub gjithashtu dhe pusetat ose mungojnë ose paraqiten në një gjendje tepër të amortizuar duke vështirësuar menaxhimin e sistemit e kullimit të ujërave të shiut. Është e nevojshme vlerësimi i kapacitetit përcjellës të tubacioneve si pasojë e ndërtimeve te reja (edhe shumë katëshe) të ndërtuara kohët e fundit në këtë zonë, duke patur parasysh zhvillimin urbanistik te zonës. Rrjeti i kanalizimeve te ujërave të zeza ka raste te ndërtimeve mbi kolektorë dhe puseta, puseta te shëmbura dhe të papërdorshme, duke vështirësuar punën e rrjetit te kanalizimeve. Shpesh here jane verifikuar bllokime dhe shperthime te ujerave te zeza. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të shiut mund të themi se është totalisht i amortizuar apo mungon fare. Ujërat e shiut në qoftë se nuk largohen nga ndonjë pusetë ose kanal , rrjedhin përgjate rrugëve ekzistuese duke krijuar pellgje apo përmytur zona te caktuara.

2.2 Përshkrimi i projektit të propozuar

“Ndërtim KUZ Lagja “Korriku”, fshati Mazhe e Madhe, Njësia Administrative Bubq, Krujë”. Projekti parashikon ndertimin kanalizimeve rreze rrugëve ne pjesen me te madhe sipas aksit ekzistuese në përputhje me parametrat e rekomanduara,

AKSI 1(KRYESOR)

Shtrirja :Lindje (L) -Perendim (P) dhe Veri(V)-Jug (J)

Gjatësia e tubit HDPE 315mm: 536ml

Gjatësia e tubit HDPE 200mm : 150ml

Puseta 50x50x100cm: 16 copë

Puseta 40x40x100cm: 6 copë

Puseta 80x80x100cm: 4 copë

Projekti parashikon ndertimin e kanalizimeve të ujërave të zeza në gjurmen e rrugeve ekzistuese. Gjerësia e rrugës së projektuar është 3.5 m asfalt dhe 4.5 m totale e cila është e ndarë

në 2 korsi kalimi automjetesh me gjerësi 2.25 metra për aksin kryesor dhe 3.0m asfalt dhe 3.5m totale për degëzimet, me një korsi kalimi. Është parashikuar të bëhet largimi i grumbujve të mbeturinave apo materialeve të tjera inerte. Projekti do të realizojë dhe rregullimin e drenazhimit të ujërave sipërfaqësorë, duke përfshirë dhe mbeturinat, duke pasur parasysh që këto të kenë efektet minimale në mjedisin përreth..

-Terreni dhe vendet me pamje të veçanta

Te gjitha te dhenat mbi popullsine e Bubqit u dhane nga ish Komuna dhe ne detyren e projektimit. Popullsia e Njesise se Bubqit deri ne vitin 2000 nga te dhenat e ish komunes eshte 9000 banore. Studiuesit demografe japin te dhena te peraferta me ato te ish Komunes.

Nje pjese e popullsise jeton ne banesa 2-4 kate dhe pjesa me e madhe jeton ne banesa private 1-2 kate. Popullsia e pritshme e qytetit deri ne vitin 2030 eshte 15000 banore.

Nje perqendrim i tille eshte verejtur veçanerisht pas vitit 1990 me lejimin e levizjes se lire te njerezve dhe shtimin e ndertimeve te shumta.

EKONOMIA

Bubqi renditet ne qendrat me nje zhvillim te mire ekonomik, tregtare te vendit. Jo vetem Bubqi e Mazhja e Madhe, por i gjithë rrethi ne teresi ka luajtur historikisht nje rol shume te rendesishem ne zhvillimin ekonomik te krejt vendit.

Ne kete zone jane te mundshme per t'u zhvilluar te gjitha aktivitetet ekonomike. Megjithate midis tyre vlen te veçohen sektore te tille si industria e cimentos, e mobilerise, ekonomia bujqesore.

Rritja e ritmeve te zhvillimit ne vendin tone, dhe atij turistik ne veçanti, kerkojne investime te vazhdueshme si per permiresimin e rrjetit rrugor ekzistues, po ashtu edhe te ndertimit te rrugeve te reja per t'iu pergjigjur trafikut gjithmone ne rritje.

Klima

Kushtet klimatike

Hidrologjia e krahines se Bubq, varet se pari nga klima, se dyti nga topografia dhe gjeologjia. Faktoret klimatike te nje rendesie paresore jane rreshjet dhe menyra e perhapjes se tyre, lageshtia, temperatura dhe era, te cilat ndikojne ne avullimin dhe transpirimin.

Temperatura e ajrit

Temperatura e ajrit regjistrohet nga termometra te vendosura ne kafaze te hapura, te njohura si kafaze Stevenson, reth 2.0 m mbi nivelin e tokes. Mbrojtja eshte e nevojshme per tu mbrojtur nga reshjet dhe rezet e djellit.

Shume vrojtime temperature behen duke perdorur termometrat maksimal dhe minimale. Keto regjistrojne temperaturat maksimale dhe minimale qe kur instrumenti eshte vrojtuar per here te fundit.

Ne nenzonen mesdhetare jugore ndryshimi ditor i temperatures shkon nga nje minimum reth agimit, ne nje maksimum nga $\frac{1}{2}$ deri 3 ore mbasi djelli ka aritur ne zenith, mbas te ciles ka nje renje te vazhdueshme gjate nates deri ne agim.

Temperatura mesatare ditore eshte mesatarja e temperatures maksimale dhe minimale dhe normalisht eshte brenda kufirit te mesatares te vertete qe regjistrohet ne menyre te vazhdueshme

Temperatura eshte matur ne grade Celsius.

Reshjet

Burimi i te gjitha reshjeve qe bien eshte dhe ndikimi i detit. Reshjet jane kryesisht ne forme shiu, por mund te ndodhin edhe si breshër, bore me shi, bore, mjegull ose vese.

Ne Shqiperi te dhenat per reshjet jane marre dhe regjistruar nga Instituti Hidrometeorologjik nga 226 (aktualisht 106) stacione matese shiu te shperndara ne te gjithe Shqiperine. Disa stacione jane te paisura me matesa qe regjistrojne ne menyre te vazhdueshme.

Matesat standarte te shiut ne Shqiperi jane bere prej llamarine dhe konsistojne ne nje cilindër me diameter 22 cm.

Reshjet ne zonen e Bubqit perbehen kryesisht prej shiut por mund te jene gjithashtu edhe ne forma te tjera, si breshër, bore me shi, bore, mjegull ose vese.

Nga pikpamja e shperndarjes se reshjeve zona konsiderohet shume homogjene.

Periudha me sasine me te madhe te reshjeve eshte gjysma e ftohte e vitit, gjate kesaj periudhe sasia mesatare e reshjeve eshte reth 70% e reshjeve totale vjetore. Ndersa pjesa tjeter e reshjeve vjetore bie ne sezonin e veres

3.3.4 Debora

Ultesira perendimore per shkak te ndikimit zbutës të detit nuk ka kushte të pershtatshme për krijimin e shtresës së bores. Ajo krijohet ralle por edhe kur krijohet nuk qëndron gjatë. Periudha me e pershtatshme për krijimin e shtresës së bores është Janar – Shkurti.

Ngricat e vjeshtës fillojnë zakonisht nga fillimi i Dhjetorit, ndërsa ngricat e Pranverës zgjasin deri në mes të Marsit

3.3.5 Era

Shpejtësia dhe drejtimi i erës në Shqipëri matet me anemometra dhe me fluger (pallake). Në seksionin Bubq shpejtësia dhe drejtimi i erës janë të ndryshueshme dhe varen nga kushtet fiziko-gjeografike të terrenit.

Shpejtësia maksimale e erës (m/s) për periudha të ndryshme perseritjeje (50,20,10,5 vjet) jepen në tabelën e mëposhtme.

Shpërndarja e rastisjes së drejtimit të erërave në bazë të të dhënave stinore tregon një ecuri vjetore të shprehur mirë. Gjatë vitit në Bubq mbizotëron drejtimi i jug-lindjes. Ky drejtim mbizotëron në mënyrë të dukshme ndaj drejtimeve të tjera, vecanërisht gjatë stinës së dimrit me një rastisje prej 25,7%. Këto janë erera që fryjnë nga brenda vendit. Gjatë verës vërehet krejt e kundërta, d.m.th. kemi mbizotërimin e drejtimit veri-perëndim me një rastisje prej 20,5%. E gjithë kjo shprehet me kontrastin e theksuar termik, gjatë verës midis tokës dhe detit, që shkakton levizjen e ajrit detar prej detit në drejtim të tokës me anë të rrymave veri-perëndimore ose perëndimore.

Në stinën e pranverës mbizotërojnë erërat veriperëndimore dhe juglindore, me rastisje përkatësisht, 16,6% kurse në vjeshtë ato juglindore, me një rastisje 18,8%. Në Bubq erërat kanë një karakter të theksuar stinor, d.m.th. gjatë gjysmës së ftohtë të vitit ato fryjnë nga thellësia e vendit, kurse gjysmën e ngrohtë të vitit ato fryjnë nga deti në thellësi të teritorit.

Muajt më të ftohtë të vitit janë Janar dhe Shkurti. Në këto muaj temperatura mesatare mujore e ajrit arrin vlerat nga 1.2 °C deri 7.0 °C. Si muaj më të ngrohtë të vitit paraqiten korriku dhe gushti ku temperatura mesatare mujore arrin shifrat nga 20.0 °C deri 24.5

Reshjet mesatare vjetore nga 2405... në 954.8....mm, pjesa më e madhe në pjesën e dimrit dhe të vjeshtës..

3.4 Gjeologjia dhe dherat

Nder dukurite fiziko-gjeologjike qe zhvillohen ne zonen e Bubqit jane; Tjetersimi dhe shkeputja shkembore. *Tjetersimi* eshte i zhvilluar ne nivelet me pjerresi te vogel ose te bute te ndertuar nga depozitimet argjilo-ranoro-alevrolitike dhe me pak eshte zhvilluar ne depozitimet flishor. Trashesia e produkteve te tjetersimit qe mbulon formacionin baze ne zonen flishore arrin deri 2.50 – 3.0 m. Ajo perfaqesohet nga suargjila me permbajtje cakelli. Ndarsa produktet aluvialo-deluviale te zones mollasike kryesisht pliocenike arrin deri 2.0 m me gjithe zonen e carjeve

3.6 Habitatat dhe biodiversiteti

Rruga qe do te rikonstruktohet kalon permes shtepive te banoreve duke kaluar ne njeh mjedis me interes ekologjik dhe me vlera natyrore.

Asnje nga speciet e rralla ose jo te rrezikshme te flares dhe faunes gjenden ne pjeset e planifikuara te rruges. Megjithate kjo zone ne teresi ka njeh shumellojshmeri bimesie.

3.7 Cilësia e ajrit

Shkarkimet e ndotjes se ajrit ne Shqipëri janë renduar qe ne fund te vitit 1980 dhe ne fillim te 1990. Gjate kesaj kohe ka pasur kontribute te ndryshme nga burime te ndryshme qe kane ndryshuar ne vazhdimesi. Shkarkimet nga prodhimet industriale kane rene per shkak te uljes se veprimtarise industriale gjate 10-15 viteve te kaluara. Ne fillim te vitit 1990 kane rene edhe shkarkimet nga banesat por po te njehat arsye dhe si pasoje e ndryshimit nga gazrat fosile ne shfrytezimin e elektricitetit. Kjo ka qellim qe te vazhdoje edhe gjate 1990. Gjate te njehthes periudhe te shkarkimeve te trafikut janë rritur si pasoje e rritjes se menjehershme ne zoterimin dhe shfrytezimin e automjeteve.

Nuk ka asnjeh rezultat te sakte ne lidhje me pershkrimin e cilësisë se ajrit ne Shqipëri per zone e projektit, por mund te themi se cilësia e ajrit ne keth zone eshte mjaft e mire pasi trafiku rrugor eshte i paketh dhe mungojneh veprimtarite industriale..

3.8 Zhurma

Organizata e Shendetit Boteror e perkufizon nivelin e zhurmes se “nje ndjenje pakenaqesie” qe sjell, ne kete rast, zhurma e makinave ne rruge. Aq me e madhe eshte zhurma dhe ndotja

atmosferike nga makinat sa me e pa shtruar te jete rruga neper te cilen kalojne. Qendra e banuara, parqet, dhe siperfaqet e tjera rekreative mund te vuajne shume nga zhurmat. Nje nga impaktet me te rendesishme te shkaktuara nga trafiku eshte zhurma e ekspozuar per njerezit qe jetojne ne banesat afer aksit rrugor ne rikonstrukcion. Ngaurvejimet e BE del qe nje numer shume i madh i popullsise ndihet teper i merztur nga zhurmat e shkaktuara nga trafiku i rruges. Zhurma ngelet nje tingull teper i merzitshem dhe i padeshiruar qe percillet vecanerisht nga individet. Niveli fizik i zhurmes nuk korrespondon direkt me nivelin e merzitjes qe ajo shkakton. Vleresimi i impaktit te zhurmes perfshin konceptin e sasise e pergjigjjeve personale te njerezve.

Zhurma e nderthurur me trafikun e rruges pergjithesisht konsiderohet qe te jete ne nje nivel me te larte apo te ulet te zhurmave, megjithese kjo nuk mund te jete nje prezantim teper drejte i zhurmave qe rrjedhin nga trafiku aktual gjate seksionit te rruges sipas projektit. Burimi me dominant i zhurmes se automjeteve jane zakonisht gomat dhe gazrat nga vjetersia. Burimet e tjera me te rendesishme te zhurmes jane motoret dhe tranzmisioni. Nivelet aktuale te zhurmes se segmentit rrugor do te jene ne varesi te kushteve te trafikut dhe perberjes se automjeteve. Aktualisht, banoret verejne se zhurma qe vjen automjetet qe kalojne ne rrugen « Koder» eshte shqetesuese kur makinat e vjetra ecin me shpejtesi.

Njesia llogaritese qe ben matjen e zhurmes eshte decibel (dB). Ato shprehen ne nje shkalle net e cilen jane te perceptuara dyfish me nivelin e zhurmave qe i korrespondon nje rritje prej 10 decibelesh. Asnje matje per zhurmat ne ambient nuk eshte bere gjate ketij studimi dhe asnje matje e sakte nuk eshte e disponueshme per rrugen e propozuar. Meqe rruga kalon mes nje rruge kryesisht rurale, zona eshte relativisht e qete dhe niveli i zhurmave ne ambient eshte relativisht i ulet.

3.9 Komuniteti lokal dhe aspekte social ekonomike

Keto kanalizime jane prane rruges korriku ne Mazhe te Madhe. Shkalla e punesimit ne zone eshte pak a shume ajo ne shkalle vendi. Nje pjesë e mirë e të rinjve të këtij qyteti kane emigruar jashte vendit; me shume se 80% e tyre ndodhen ne Itali dhe pjesa tjeter ne Greqi. Ata jane te lidhur me familjet e tyre dhe pothuaj te gjithë gjate sezonit të verës kthehen per pushime, gje e cila shkakton nje ngarkese te madhe ne rruge per shkak te automjeteve te shumta qe ata marrin me vete. Nga ana tjeter, eshte shume i rendesishem fakti qe ata veçse ndihmojne familjet e tyre me te ardhura kane filluar edhe te investojne. Investimet ne kete zone per shkak te pozites

gjeografike dhe pranise se tregut, jane te shumta. Pjesa tjetër e popullsisë e cila ka vendosur të jetojë aty merren më shumë me aktivitete private, janë të punësuar në to apo janë pronarë.

3.10. Trafiku dhe siguria rrugore

Kerkesa e trafikut percaktohet si nevojë zhvillimi, rritje shërbimesh si dhe sigurimin e një cilësie jete me komode. Në Shqipëri, për shkak të prapambetjes së madhe në infrastrukturën rrugore, megjithë përpjekjet e bëra nga ekipe të ndryshme qeveritare, perseri kërkesa për rrugë është e lartë. Nga ana tjetër, rritja brutale e mjeteve motorrike në përdorim vetiak dhe/ose familjar kërkojnë rrugë të shtruara dhe të gjera.

Është llogaritur se vetëm si pasoje e sistemit të degraduar të rrugëve humbjet për qytetarët dhe bizneset janë shumë të mëdha (harrxhohet me shumë se 30% e karburantit që nevojitet për të njeten trajet dhe po aq kohë e humbur. Dëmi është i dyfishtë: (i) humbje ekonomike me me shumë se 30% e asaj që nevojitet në kushte normale dhe (ii) ndotja është rreth 35-40% më lartë se ajo e shkaktuar në kushte normale.

Siguria Rrugore: Aksidentet rrugore janë shkak i dytë i vdekjeve në Shqipëri (pas atyre të semundjeve kardiovaskulare) dhe së situata vjen duke u përkeqësuar për shkak të rritjes së menjehershme të trafikut. Organizatat ndërkombëtare financuese po bëjnë investime të mëdha për sjelljen në funksionim normal të rrjetit rrugor në Shqipëri.

Shqipëria ka nivelin më të lartë të aksidenteve fatale, vlerat janë shprehur zyrtarisht, ndërmjet vendeve të tjera europiane. Çështja e sigurisë rrugore dhe kërkesës për të patur një mirëmbajtje sa më të përshtatshme rrugore mbetet tepër themelore në dritën e statistikave zyrtare e cila tregon qartë se nivelet e trafikut në infrastrukturën rrugore do të duhet të rriten edhe për një periudhë 10 vjeçare me ritëm 10% në vit.

4. IMPAKTET E RËNDËSISHME MJEDISORE

4.1 Trashëgimia Arkeologjike dhe Kulturore

Segmenti rrugor kalon nëpër trasenë e një rrugë që tashmë është në funksion dhe në këtë mënyrë nuk do të ketë pasoja në trashëgiminë kulturore apo arkeologjike të zonës. Për këtë arsye nuk nevojiten masa të veçanta të ruajtjes apo konservimit të tyre specifike.

Ndonse nuk ka te dhena per mbetje arkeologjike ne vendet qe do te gerrmohet gjate ndertimit te rruges, nese do te hasen te tilla gjate ndertimit, atehere punimet do te ndalohen menjehere ne ate perimenter dhe do te pritet ekspertiza e specializuar per te vleresuar ecurine e metejshme te projektit. Punimet do te rinisin serish vetem pasi te jete leshuar konfirmimi nga autoritetet kompetente. E nejta procedure do te ndiqet edhe ne vendmarrjet e inerteve per ndertimin e segmentit ne rastet kur hasen objekte arkeologjike te rendesise se vecante.

4.2 Terreni dhe pamjet piktoreske

Do te jene ne qender te vemendjes. Ne pergjithesi, me qe aksi i rruges eshte i hershem, nuk pritet qe te kemi modifikime te pamjeve pamore nga qendrat e banuara tashme. Pemet dhe bankinat e mundeshme (ngritje dhe ulje te terrenit per shkak te nivelimit te rruges) tashme jane konsoliduar dhe per me teper nuk do te kete çvendoseje masive dheu nga karexhata e rruges dhe as mbushje te rendesishme. Problemi mund te paraqitet ne rastet kur kapicat e dheut ku do te merret materiali inert per mbushjen dhe shtrimin e rruges do te vendosen ne sheshet kryesore pranë vendbanimeve. Per kete do te kete konsultime dhe do te terhiqet opinionimi i publikut per vend depozitimet e materialeve inerte. Do te synohet qe te identifikohen pamje te fshehura te tyre me qellim qe te mos cenohet bukuria e peisazhit dhe as bimesia pergjate aksit rrugor.

Nje rendesi per impaktin pamor do te kete zgjerimet eventuale te karrexhates se rruges pergjate akseve te rruges do te shkaktoje demtimin ne shkalle te vogel te bimesise pergjate rruges. Çdo punim rrugor, edhe ne rastin kur ajo ndertohet ne aksin ekzistues te nje rruge te meparshme, ka ndikim ne mjedisin ku ajo kalon. Rruga me prezencen e vet dhe me ngjyren e zeze te shtreses se asfaltit eshte jashte “ndertimit” natyror, perpos faktit qe ajo krijon probleme konkrete te habitatit ekzistues.

4.3 KLIMA

Impakti i projektit ne klimen e zones perreth nuk eshte i rendesishem dhe per kete arsye gjate ndertimit dhe venien ne funksionim te saj nuk do te kete asnje kerkese per sherbime lehtesuese.

4.4 Gjologjia dhe Dherat.

Sipas skemes se projektit nuk pritet te kete asnje impakt mbi gjeologjine e rajonit dhe/ose zones. Ne trasene ku rruga kalon do te kete vetem nje gerrmim te lehte, jo me shume se 16 cm dhe mbushje jo me shume se 16 cm. Gjithe materiali qe do te çvendoset do te ngarkohet ne makina

dhe do te depozitohet ne nje vend depozitimi qe do te paracaktohet ne bashkepunim me organet komunale. Nuk priten te kete gerrmime/mbushje anesore perderisa rruga ekzistuese siguron gjeresine e kerkuar ne projekt.

4.5 Hidrologjia, Ujrat siperfaqesore dhe Nentokesore

Ujrat nentokesore ne aksin e rruges jane afer siperfaqes; ato ndodhen ne thellesi 2-4 m dhe ne kete menyra ato jane te ndjeshme perkarshi cdo depozitimi ndotes. Nisur nga volumi i punimeve (gerrmime dhe depozitime te vogla te dherave dhe sedimenteve) nuk parashikohet ndonje impakt direkt dhe i rendesishem i punimeve ne keto ujra. Me potenciale ne lidhje me ndotjen e ujrave nentokesore jane depozitimet/rrjedhjet e vajrave lubrifikante dhe/ose karburanteve te makinave te renda gjate punimeve ose, me pas, gjate udhetimeve. Edhe ne rast te derdhjeve te pa vullnetshme (derdhje aksidentale) por edhe ndrrim i vajit ose rrjedhje te tij nga ana e makinerive te renda mund te ndotin ujrat nentoksore.

Ne rast derdhjesh te rendesishme te karburanteve dhe/ose vajit lubrifikant, hidrokarburet, per shkak te gravitetit do te levizin drejt thellesise duke u bashkuar me ujrat nentokesore. Po ashtu, ne perzjerje me ujrat siperfaqesore ato do te levizin bashke me ujin dhe keshtu ndotja do te jete me e madhe.

4.6 Habitati dhe biodiversiteti

Ndërtimi i rrugës se propozuar mund te çojë ne humbje te përhershme te tokës qe nevojitet për rrugën e projektit, e cila mund te çojë ne shkatërrimin e habitateve, veçanërisht atje ku ekziston bimësi qe duhet te hiqet. Zonat që mund të preken me shumë nga këto ndikime mund të jenë ato afër zonave të mbrojtura, pasi aty ka një diversitet të lartë natyror dhe është një zonë me vlera natyrore.

Gjate ndërtimit do te ketë një numër ndikimesh te vogla direkte apo indirekte te tilla si pastrimi I bimësisë, gërryerjet e skarpateve ne gërmime dhe mbushjet, prerja e drurëve te dobishëm etj.

Një pozicionim i pavëmendshëm i ndërtimit te kantierit te Kontraktorit dhe kampit te tij mund te sjelle shkatërrimin e habitateve natyrore dhe ne migrimin e popullsisë se faunës larg nga kjo zone për shkak te shqetësimit ne zone. Përveç kësaj një kontroll i pakët në lidhje me mbeturinat e lëngshme dhe te forta nga kantieri, se bashku me derdhjet apo shkarkimet e karburanteve dhe

lubrifikanteve, mund të sjellë popullimin e dherave, degjenerimin e habitatit dhe dëmtimin apo shkatërrimin e foleve të zogjve shtegtare dhe llojeve të tjera të ngjashme.

Ndotja e ajrit, zhurmat dhe tronditjet e tokës për shkak të ndërtimit mund të sjellin në migrimin e popullatës së kafshëve për shkak të shqetësimit në zonë dhe zvogëlimit të efektit të shtegtit të zogjve në afërsinë e rrugës. Një pluhur i tillë nga ndërtimi i rrugës mund të sjellë degjenerimin e habitatit dhe reduktimin e burimeve ushqyese për speciet e faunës. Gjate fazës së ndërhyrjeve pasojë me dëmtuese mund të jetë vrasja e kafshëve që kalojnë rrugën.

4.7 Cilësia e ajrit

Faza e ndërtimit të një skeme rrugore mbetet burim shkarkimesh të substancave të caktuara që mund të kenë një impakt të përkohshëm në cilësinë e ajrit përreth kantierëve të ndërtimit. Gjate fazës së ndërtimit shkarkimi i pluhurave bashkohet me veprimtari të ndryshme siç është heqja e pemëve dhe dherave, gjurmimi i dherave dhe vendosja e po të njëjtit material në bankina dhe në strukturën e ndërtimit.

Shkarkimi i pluhurave varet në radhë të parë nga kushtet e kohës dhe në nivelin e veprimtarisë dhe llojin e ndërhyrjes që do kryhet. Gjithashtu pluhuri ngrihet nga rrotat e automjeteve të rënda të ndërtimit sepse ato kalojnë gjatë kantierit të ndërtimit gjatë periudhës së nëntë.

4.8 Zhurmat

Gjatë ndërtimit priten që zhurmat të shkaktohen nga makineritë e rënda të cilat do të transportojnë materialet/mbetjet që do të dalin nga gjurmimi dhe/ose ato që nevojiten për mbushje. Zhurmat do të jenë prezente gjatë fazës së ndërtimit dhe do të jenë shqetësuese për një distancë deri në 150 m.

4.9 Komuniteti Lokal dhe Aspekte Social Ekonomike

Impaktet janë si pozitive ashtu edhe negative:

Efektet më të rëndësishme pozitive janë:

- Rruga do të lehtësojë lëvizjen e automjeteve dhe rritjen e volumit të transportit.
- Do të lehtësojë dhe përmirësojë lëvizjen.
- Kjo rrugë do të krijojë një lidhje më të mirë për rajonin
- Do të rrisë numrin e turistëve duke rritur kështu dhe të ardhurat.

Efektet negative konsistojne:

- Gjate ndertimit do te kete pluhur dhe zhurma (me shume se zakonisht),
- Gjate fazes se ndertimit mund te shkeputen tuba te frunizimit me uje,
- Gjate ndertimit kanalet e drenazhimit mund te bllokohen,
- Shpejtesia e automjeteve do te rritet dhe mundesia per aksidente eshte me e madhe, sidomos ne qendrat e banuara.

5. MASAT E PROPOZUARA LEHTESUESE

Gjatë përgatitjes së VNM për nën-komponentë të ndryshëm duhet të merren në konsideratë të gjitha efektet pozitive dhe negative të shkaktuara nga aktivitetet e ndërtimit, operimit dhe mbylljes/mirëmbajtjes mbas mbylljes, përfshi dhe aksidente të mundshme ekologjike. Për komponentët kryesorë të projektit, studimet e para – fizibilitetit kanë identifikuar një numër efektesh të mundshme. Këto përfshijnë rreziqe të lidhura me shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve të ndërtimit dhe publikut, zhurmën, pluhurin – që sjell efekte negative mbi cilësinë e ajrit; ndotje të dheut dhe ujit; rrjedhje sipërfaqësore, germimin e materialeve dhe hedhjen e dheut të tepërt; dhe rreziqet ndaj zonave të ndjeshme të mjedisit.

5.1 Masa te Pergjitheshme

Ne kontekstin e nje mase lehtesimi gjate ndertimit, kontraktori i rruges do detyrohet te pergatise nje plan ambjental qe siguron se:

- Punime ndertimi te realizohen kryesisht gjate dites,
- Kanalet ujtese dhe kulluese, kanalet anesore, rrjedhat e ujit te mbahen ne nje regjim minimum gjate punimeve maksimum ne rruge,
- Materialet e ndertimit do te merren ne vendin e prodhimit te inerteve,
- Mbeturinat e e germimit do te grumbullohen ne vende te posaçme te caktuara paraprakisht nga pushteti vendor dhe kontraktori,
- Aksi rrugor qe riparohet (germin/mbushje) duhet te ujitet gjate periudhave te thata per te menjanuar shkarkimet e pluhurave, kjo e domosdoshme ne afersi te qendrave te banuara,
- Zonat me depozitime te perkohshme do te rehabilitohen per perdorimet te metejshme te tyre sipas destinacionit te meparsheme.

- Punime ndërtimi të ndodhin kryesisht gjatë sezonit të thatë,
- Mbeturinat e forta dhe të lëngshme duhet të grumbullohen dhe/ ose riciklohen,
- Platforma rrugore ujitet gjatë periudhave të thata për të mënjeluar shkarkimet e pluhurave,
- Pemë tepër të vlefshme duhet të mbrohen.

5.2 Masa te veçanta

5.2.1 Zhurmat

Ndertuesi gjate fazes ndertuese, eshte i obliguar te zbatoje te gjitha masat kunder zhurmes, ne pershtatje me direktivat e BE (Rregullat e Niveleve te Pranueshme te Zhurmave, 1988). Masat qe duhen aplikuar konsistojne si me poshte:

1. Ne zonat e banuara:

- Punimet nderpriten gjate nates
- Punimet ne afersi te shkallave nderpriten gjate orarit mesimor (8:00 deri 13:00)
- Mjetet gerrmuese dhe ato transportuese do te perdorin detyrimisht silenciatore.
- Kompresoret duhet te pershtaten sipas modeleve perkatese me kapaket e radhitur dhe te mbyllur mire te cilet do te mbahen mbyllur per sa kohe qe makinerite jane ne pune dhe te gjitha mjetet e tjera shtese pneumatike qe do te pershtaten me silenciatoret perkates,
- Makinerite qe do kene shfrytezim te here pas hershem do te mbyllet here pas here ne kohen kur nuk do te nevojitet per shfrytezim,

Persa i perket aktiviteteve te tjera jetesore dhe bizneseve:

Ndertimet e reja per banim (shtepite) si dhe ndertesat per biznese duhet te behet ne baze te studimeve dhe planeve qe jane ne perputhje me rregulloren dhe mbrojtjen e natyres permes stimulimit te politikave te reja sipas legjislacionit ne fuqi,

- Harmonizimi sa me i mire i interesave dhe prioriteteve me njera tjetren per te rritur edhe me shume zhvillimin ekonomik, mireqenien dhe miqesore me mjedisin.

Gjate procesit të konsultimeve publike, nga ana e perpiluesve të këtij studimi mjedisor, rezultoi se nuk ka asnjë zhvendosje të 'komunitetit', dhe se asnjë pronar nuk do të "sakrifikohet" shtepia ose prona.

5.2.2 Konsultimi Publik

Konsultimet janë një pjesë tepër e rëndësishme e procesit të VNM. Në linjë me zhvillimin e VNM është përgatitur një strategji për konsultimet. Konsultimet në çështjet ambientale janë bazuar në 'Konventën e Aarhus', e cila përshtat një pikëpamje me baze të drejte dhe fokusohet në ndërveprimet mes autoriteteve të publikut dhe vetë publikut në një përmbajtje me demokratike.

Objektiva të veçanta të fushatës së informacionit publik dhe konsultimet publike janë përmbledhur si më poshtë:

- Për të ndarë plotësisht informacionin rreth projektit të propozuar, përbërësit e tij dhe veprimtaritë me gjithë personat e prekur;
- Të arrihej informacion rreth nevojave dhe prioriteteve të personave të prekur, si edhe rreth reagimeve të tyre për çështjet dhe veprimtaritë e propozuara;
- Të arrihet bashkëpunimi dhe pjesëmarrja e njerëzve të prekur si dhe komuniteteve në veprimtaritë e kërkuara që duhet të ndërmerren
- Të sigurojë transparencë në të gjitha veprimtaritë lidhur me zotërimin e tokës, rivendosjen dhe rehabilitimin.

5.2.3 Plani i menaxhimit ambiental

Plani i Menaxhimit Ambiental (PMA) përcakton mënyrat se si do të bëhet monitorimi i impakteve ambientale që do të ndërmerren dhe zbatimin e masave lehtësuese që do përfundohen në fazën e ndërtimit. Drafti i PMA do të ketë nevojë të përpunohet me zhvillimin e Fazës II.

PMA është një dokument në evoluim dhe do të ndryshojë vazhdimisht sa më shumë të bëhen të ditura detajet e punimeve të rehabilitimit dhe ndërtimit dhe mendimet publike.

Drafti i PMA konsiston në sa më poshtë:

- Një Plan i Lehtësimit Ambjentalist (PLA), që nënvizon masat që duhen marre për të lehtësuar ndikimet negative gjatë fazave të ndryshme të Projektit;
- Një Plan Monitorimi Ambjentalist (PMoA), që përcakton parametrat ambientaliste për t'u observuar dhe raportuar gjatë fazave të ndryshme të Projektit;

Një Plan Menaxhimi Ambjental (PMA) po përgatitet si pjesë e studimit të VNM-se me qëllim që të përcaktojë masat për ruajtjen e mjedisit dhe procedurat që nevojiten për tu përshtatur me projektin si edhe për të njohur Përgjegjësitë e tyre gjatë zbatimit. PMA do të kompletohet kur procesi i projektimit do të ketë përfunduar dhe metodologjia e punës së Kontraktorit njihet dhe është përcaktuar përfundimisht. Kjo mund të rishikohet gjatë zbatimit të projektit.

PMA është ndërtuar të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- *masat lehtësuese;*
- *plani i monitorimit të ambientit;*
- *masat institucionale që do të ndërmerren gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të projektit;*
- *veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit.*

Plani Monitorimit të Mjedisit do të përcaktojë mënyrat sipas të cilave do të kryhet monitorimi i ndikimeve në ambient dhe zbatimi i masave lehtësuese gjatë fazës së ndërtimit. Monitorimi do të përqendrohet në numrin e kufizuar të ndikimeve të identifikuara gjatë VNM-se për të siguruar efikasitetin e masave lehtësuese të planifikuara.

5.2.4 Komuniteti Lokal dhe aspektet Social-Ekonomike

Gjatë ndërtimit do të merren masa të veçanta nga ana e kontraktorit, me qëllim që të bëhet mirëmbajtja e ujit, elektriciteti dhe shërbimet e tjera për qytetaret përreth.

ndërtimi i rrugës do të inkurajojë në gjithë zhvillimin e zonës turistike përreth. Përmirësimi i rrugës së projektit do të inkurajojë turistët që kanë një rëndësi të madhe. Nga ana tjetër, aktivitete të tjera duhet të zhvillohen në zonën përreth duke siguruar pjesën më të rëndësishme të infrastrukturës.

Te mëposhtmet janë rekomandime te përgjithshme, te cilat mund te ndihmojnë ne mirëmbajtjen e këtij investimi sa me shume të jetë e mundur si një instrument tepër i fuqishëm dhe i zhvilluar i mundshëm për:

- Biznesin vendas dhe te huaj qe duhet te drejtohet drejt sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë, si turizmi, nga ndihma e projekteve;
- Prodhimet më tradicionale përfituese që duhen stimuluar;
- Sektori i turizmit duhet të asistohet dhe të ndihmohet edhe më mirë (rreth e rrotull, urban, familjar, kulturor, historik etj.) duke e bërë komunitetin më të vetëdijshëm dhe duke përmirësuar infrastrukturën e turizmit.
- Interesat dhe prioritetet për tu harmonizuar sa më mirë me njëra tjetrën për të rritur edhe me shume zhvillimin ekonomik mirëqenien dhe pa asnjë impakt në ambient.

5.2.5 Terreni dhe vendet me pamje të veçantë

Një konsiderate e veçante i është dhënë mënjanimi te impakteve kudo qe shihet si e mundur gjate përzgjedhjes dhe projektimit te Skemës se Propozuar. Ne lidhje me këtë gjurma rrugore është përzgjedhur për te minimizuar impaktin ne zonat e banuara, detajet topografike, pemët dhe ku është e mundur ne pyje. Për këto arsye u zgjodh që dhe rruga e propozuar të kalojë në gjurmët e rrugëve ekzistuese në mënyrë që impakti mjedisor të ishte sa më i vogël.

5.2.6 Gjeologjia dhe Dherat

Kapicat e dherave kudo që do zhvendosen duhet të menaxhohen saktësisht dhe të depozitohen para se të ripërdoren. Kjo duhet të jetë praktike që të përdoret menjëherë pas gërmimeve dhe nëse jo duhet të depozitohet në lartësira prej jo më shumë se 2 m.

Ne përfundimin e rrugës, do te ndërmerren inspektive vizuale në të gjitha strukturat gjatë gjurmës rrugore, që mund të ndërmerren për të siguruar që strukturat rrugore nuk shkaktojnë erozion, dhe që të identifikojnë kërkesat e duhura dhe ato që duhen për të ndërmarrë çdo punë të menjëhershme. Kjo mund të minimizojë impaktet e mundshme të ardhshme të humbjes së dherave dhe impakteve të lidhen me terrenin si shkak i erozionit.

5.2.7 Hidrologjia, Ujërat Sipërfaqësore dhe Nëntokësore

Gjate ndërtimit shkarkimi i mundshëm i materialeve në ujë mund të konsiderohet një impakt negativ. Megjithatë raporti i VNM i kërkon palës së Kontraktorit që të zbatojë procedura të qëndrueshme gjatë ndërtimit për të ulur rrezikun e ndotjes së rrjedhave të ujërave.

Gjate procesit të ndërtimit do të vendosen edhe masat për kontrollin e ndotjes. Këto do përfshijnë kushtin për gardhimet.

Derdhja e materialeve që shkarkohen nga kantieri i ndërtimit do të trajtohet në përputhje me llojin e tyre. Në rastin e një derdhje serioze të kimikateve apo lëngjeve gjatë ndërtimit, do të përcaktohet nga ana e Kontraktorit një program për matjet e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Testimi i ujërave nëntokësore duhet të bëjë matje në terren të pH, turbulencën dhe nxitjen elektrike.

Për periudhën kur rruga është në ndërtim e sipër, duhet të merren masa lehtësuese për kohe të gjate para se të nisë kontrolli i ndotjes dhe parandalimi i rrezikut.

5.2.8 Habitati dhe Biodiversiteti

Humbja e tokës dhe shkatërrimi i habitateve për shkak të ndërtimit të rrugës është i paevitueshëm. Megjithatë përzgjedhja e gjurmës së rrugës gjatë fazës së projektimit është tepër e rëndësishme. Edhe pse kemi të bëjmë me një rikonstruksion të një gjurme rruge humbja e habitateve me vlerë do të konsiderohet si një problem dhe do merren masa që në pjesët ku do të jetë i nevojshëm largimi i bimësisë, pas përfundimit të punimeve të rehabilitohet zona duke mbjellë anash rrugës bimësi apo pemë.

Për të minimizuar impaktin nga ndërtimi i gjithë zhurmave dhe dridhjeve, kontrata do limitojë veprimtaritë e ndërtimit gjatë orëve të arsyeshme, normalisht ndërmjet orës 23 deri në 07 të mëngjesit. Mënyrat më të mira që duhen praktikuar duke përfshirë një impiant të mirëmbajtjes së përshtatshme, që do të punojë në minimizimin e zhurmës që vijnë nga punimet në kantier. Të gjitha automjetet dhe impiantet mekanike do të përshtaten me silenciatorë kundër zhurmave dhe do të mirëmbahen në gjendje të mirë pune gjatë gjithë periudhës së kontratës. Kompresorë do të përshtaten me modele që duhet të vihen në mënyrë të përshtatshme dhe do të izoloohen me kapakë

akustike të cilët do të mbahen te mbyllura kurdo që makineritë janë në përdorim e sipër dhe do të përshtaten me anë të mjeteve pneumatike ndihmëse me silenciatorët e përshtatshëm.

5.2.9 Cilësia e Ajrit

Nivelet e trafikut të projektuar për kohe afat gjatë janë tepër të ulëta dhe si të tilla ato shkaktjnë shkarkimet tepër të pakta.

Gjatë fazës së ndërtimit zbatimi i sistemeve për ngjeshjen e pluhurit siç është lagja me ujë e rrugëve e cila do të ndërmerret nga kontraktori për të limituar deri diku shkarkimet e pluhurit. Përveç kësaj makineria e ndërtimit do të nevojitet për të përmbushur të gjitha standardet e shkarkimit që udhëzon BE.

6. MONITORIMI MJEDISOR

Plani i Monitorimit Mjedisor përcakton menyrat se si do të bëhet monitorimi i impakteve mjedisore që do të ndërmerren dhe zbatimin e masave lehtësuese që do të perfundohen në fazën e ndërtimit.

Monitorimi do të përqendrohet në impaktet e identifikuar gjatë raportit të VNM për të siguruar ecueshmerinë e masave lehtësuese që janë planifikuar. Me poshtë, në formë tabelare paraqesim përmbledhjen e monitorimit, përgjegjësitë, menyrat dhe kohën e kryerjes.

Plani i Lehtësimit Ambientalist

Komponenti Mjedisor	Ndikimet e Mundshme	Masat Lehtësuese	Përgjegjësia	Afati
<i>Mjedisi Fizik</i>				
Dherat	- Dëmtime të strukturës së dheut si pasojë e ruajtjes së materialeve, trafikut të transportit, etj. - Humbja e dheut sipërfaqësor gjatë gërmimeve apo hedhjes së materialeve të ndërtimit - Erozioni si pasojë e rrjedhjeve sipërfaqësore të pakontrolluara dhe shkarkimit të mbeturinave ujore	- Mbrojtja e zonave jo-ndërtimore, shmangia e punimeve në zonat e ndjeshme gjatë kushteve me negativitet të lartë, sigurimi i rrugëve për transport, sipas nevojës, riparimi i zonave të dëmtuara - Heqja e dheut sipërfaqësor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja mbas mbarimit të ndërtimeve - Projektimi i drenazheve e strukturave për të siguruar stabilitetin e dheut sipërfaqësor	Kontraktori i zbatimit të punimeve	Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve

Komponenti Mjedisor	Ndikimet e Mundshme	Masat Lehtësuese	Përgjegjësia	Afati
Toka	- Dëmtime të tokës gjatë ndërtimit. Rrëshqitje mbi skarpate, faqe kodrash, etj. - Efektet e gërmimeve / hedhja e dheut dhe materialeve të tjera	- Mbrojtja e zonave jo-ndërtimore - Kryerja e punimeve në mënyrë të tillë që të minimizohet sipërfaqja e ndikuar e tokës - Projektimi i sipërfaqeve të pjerrëta dhe strukturave mbajtëse për të minimizuar rrezikun, sigurimi i drenazheve dhe stabilizimit të dheut/mbulimit të bimësisë - Hedhja e dheut sipërfaqësor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja/ ripërdorimi mbas mbarimit të ndërtimeve - Transportimi/hedhja e materialeve nga/në vende të aprovuara	Kontraktori i zbatimit të punimeve	Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve
Burimet Ujore	- Ndërprerja e drenazhimit sipërfaqësor dhe nëntokësor gjatë dhe mbas fazës ndërtimore, krijimi i ujit të ndenjtur - Ndotja/infektimi i burimeve nga punimet ndërtimore, mbeturinat njerëzore apo të kafshëve përfshi karburantet & vajrat, mbetjet e rrezikshme, mbeturinat ujore, sedimentet, etj. - Rritje e rrjedhjeve dhe e rrezikut të përmytjeve - Përmytje si pasojë e bllokimit të drenazhimeve dhe strukturave drenazhuese, etj.	- Projektimi i kujdesshëm – ruajtja e drenazhimeve natyrore kur është e mundur, të konsiderohen shtrirje alternative - Ruajtja e kujdesshme e materialeve dhe mbeturinave të rrezikshme, sigurimi i drenazhimeve të përshtatshme për mbeturinat ujore dhe derdhje e kujdesshme e mbeturinave - Të zbutet shpejtësia dhe volumi i rrjedhjeve, të sigurohen struktura mbajtëse/ sedimentimi sipas nevojës	Kontraktori i zbatimit të punimeve	Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve

Komponenti Mjedisor	Ndikimet e Mundshme	Masat Lehtësuese	Përgjegjësia	Afati
Cilësia e Ajrit	- Pluhuri gjatë dhe mbas fazës ndërtimore, sipas sipërfaqes së rrugës - Tymrat e trafikut gjatë fazës ndërtimore dhe rritje e mundshme mbas fazës ndërtimore	- Të kontrollohet pluhuri me ujë - Të kontrollohen metodat e ndërtimit dhe impianti, afatet e punimeve - Të kufizohet shpejtësia e automjeteve dhe kalimi i trafikut në zonat rezidenciale gjatë dhe mbas fazës ndërtimore - Projektim i kujdesshëm, sidomos në pikat me rrezikshmëri	Kontraktori i zbatimit të punimeve	Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve
Mjedisi Akustik	Zhurma nga punimet ndërtimore, trafiku – shpejtësia, sasia dhe lloji i trafikut gjatë dhe mbas fazës ndërtimore	- Të përcaktohen afate të punimeve për të minimizuar shqetësimet - Të përdoren metoda dhe pajisje të përshtatshme ndërtimi - Të kufizohet shpejtësia e automjeteve dhe kalimi i trafikut në zonat rezidenciale, sidomos e kamionëve, duke përdorur shenja dhe projektim të përshtatshëm	Kontraktori i zbatimit të punimeve	Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve
<i>Mjedisi biologjik</i>				
Habitatet Natyrore	Shqetësimi ose humbja e habitateve natyrore dhe shqetësimi i zonave të mbrojtura gjatë dhe mbas fazës ndërtimore	- Vendndodhje e kujdesshme e kantierit, kryerje me kujdes e shtrirjes dhe projektimit të strukturave (sidomos për rrugët e reja), dhe/ose përcaktimi i kohës së punimeve (sezonale) - Përzgjedhja me kujdes e pikave të hedhjes së mbeturinave dhe metodave, - Mbrojtja e zonave të ndjeshme brenda/afër kantierit	- Bashkia - Kontraktori i zbatimit të punimeve	Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve

Komponenti Mjedisor	Ndikimet e Mundshme	Masat Lehtësuese	Përgjegjësia	Afati
Fauna dhe Flora	Humbja ose degradimi gjatë dhe mbas fazës ndërtimore, sidomos për arsye të punimeve jashtë sezonit, ndryshimeve në regjimet mjedisore, p.sh ç'rregullimi i lëvizjeve të kafshëve të egra gjë që shkakton vrasje të tyre nga automjetet, etj. (shih edhe më sipër)	- Vendndodhje e kujdesshme e kantierit dhe projektim i kujdesshëm për të minimizuar efektet, sidomos për speciet e ndjeshme/të rralla - Të merren në konsideratë shtrirje alternative dhe/ose vendosje të strukturave - Përzgjedhja e metodave të përshtatshme ndërtimore - Mbrojtja e zonave të ndjeshme brenda/afër kantierit - Të punohet në mënyrë sezonale, sipas nevojës	- Bashkia - Kontraktori i zbatimit të punimeve	Gjatë projektimit/ Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve
<i>Mjedisi Social</i>				
Estetika dhe Terreni	- Efekte lokale vizuale mbas përfundimit të punimeve dhe disa ndryshime në terrenin e përgjithshëm natyror dhe të krijuar, humbje pemësh, bimësie, etj. - Zhurma, pluhur, mbeturina, etj. gjatë dhe mbas fazës ndërtimore	- Vendndodhje e kujdesshme e kantierit dhe kryerje me kujdes e projektimit të punimeve, kontroll i objekteve të papërshtatshme - Zëvendësim i pemëve të dëmtuara, strukturave të kufijve, etj. dhe ri-gjelbërim i zonave të punimeve - Kryerje me kujdes e mbylljes dhe rregullimit të pikave të punimeve dhe hedhje e mbeturinave	Kontraktori i zbatimit të punimeve	Gjatë projektimit/ Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve

Komponenti Mjedisor	Ndikimet e Mundshme	Masat Lehtësuese	Përgjegjësia	Afati
Shëndeti i Njerëzve	- Rreziqe për shëndetin dhe sigurinë gjatë dhe mbas fazës ndërtimore - Efekte mbi shëndetin nga mbeturinat e materialeve të rrezikshme të ndërtimit, aksidente këmbësorësh dhe automjeteve, - Transporti i substancave të rrezikshme	- Të zgjidhen kontraktorë me eksperiencë. të përshihen masa sigurie dhe kërkesat mjedisore në dokumentet e kontratës. - Të sigurohet informacion mbi masat zbutëse. Krijimi i kapaciteteve të theksojë nevojën për punime më siguri, mbikqyrje të mirë, planifikim dhe parashikim të kujdesshëm të punimeve, përfshirja e komunitetit, rrethimi i zonave të rrezikshme - Hedhje e kujdesshme e mbeturinave - Projektim i sakte, përfshi dhe masat e sigurisë në pikat e rrezikshme, rrethim, shenja rrugore, etj. - Kufizimi i lëvizjes së materialeve të rrezikshme në zonat rezidenciale	- MPPTT - Konsulenti - Kontraktori i zbatimit të punimeve	Gjatë projektimit/ Për tu specifikuar në dokumentet e tenderit
Komunitetet e Njerëzve	Ndryshimet sociale (rrugë të reja)	Projektim i sakte për të minimizuar efektet sociale (për më në përgjithësi shih më sipër)	Konsulenti	Gjatë projektimit
Objektet Historike /Kulturore	Shqetësim/dëmtime/degradim i objekteve të njohura dhe të pazbuluara	- Vendosje/kryerje e kujdesshme e punimeve; masa të posaçme për zonat/burimet e njohura - Të ndalohet puna menjëherë në afërsi të zbulimeve dhe të priten udhëzime nga autoritetet përkatëse	- Kontraktori i zbatimit të punimeve - Bashkia	Në vazhdimësi gjatë fazës së punimeve

Plani i Monitorimit Ambientalist

Faza	Aktiviteti Monitorues	Përgjegjësia	Zbatimi
Faza e Para-Punimeve/Vijës-Baze			
	- Koordinim me Kontraktorët e tjerë për punimet ne infrastrukture ne te njëjtën zonë - Siguria e mirëmbajtjes së shërbimeve ekzistuese (linjat telefonike, elektrike etj)	- Bashkia / Supervizori - Bashkia / Supervizori	- Ne fillim te Fazës 2 - Para përfundimit te Fazës 1
Faza e Punimeve			
	- Probleme për popullatën lokale: zhurme, ajër i ndotur, pluhur - Respektimi i PMA nga Kontraktorët: kontrolli i erozionit, mbrojtja e bimësisë, ndotja e terrenit dhe ujit. - Zbatimi i masave te sigurisë nga Kontraktorët konform standardeve profesionale. - Gjetja e alternativave për funksionimin normal te trafikut	- Kontraktori nen kontrollin e Bashkisë dhe te Supervizorit - Bashkia - Bashkia - Policia rrugore	- Gjate mbikëqyrjeve periodike te punimeve - Gjate mbikëqyrjeve periodike te punimeve - Mujore - Gjate zbatimit te punimeve.
Përfundimi/Faza Operative			
	- Siguria Rrugore, trafiku - Pastrimi përfundimtar i zonës	- Bashkia - Kontraktori i zbatimit të punimeve	- E përditshme pas vënies ne funksionim - Pas vënies ne funksion

HARTOI
 “ERALD-G” SH.P.K
 ING.GËZIM ISLAMI